

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-201/14

Prishtinë,
26 Tetor 2016

Në çështjen juridike të:

K. Š.

Pala ankuese

Nuk ka

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtaret: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Beshir Islami dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/220/2013 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin (KPA17777) të datës 27 nëntor 2013), pas shqyrtimit të mbajtur më 26 Tetor 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM:

Hidhet poshtë si e palejueshme ankesa e K. Š. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/220/2013, të datës 27 Nëntor 2013, për sa i përket lëndës nr. KPA1777

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 1 Shtator 2007 V.Š., (në tekstin e mëtejme: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkon konfirmimin e pronësisë së të ëmës M.Š. mbi pronën e paluajtshme që gjendet në zonën kadastrale Kodralija, ngastra kadastrale 305/2 më vonë 33/1 me sipërfaqe prej 0.89.99 ha komuna e Deçanit (më tej: prona e kërkuar). Në kërkesë ka deklaruar se nuk ka inicuar procedurë trashëgimorë dhe nuk e di se kush e shfrytëzon pronën e kërkuar
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar dokumentet në vijim:
 - Vërtetimin e përkohshëm të ndarjes së pronës lëshuar nga Mbretëria e Jugosllavisë Organi i Reformës Agrare (ser. Agrarno poverilastvo, eng. Agrarian Trustee) datë 25 Korrik 1939 që dëshmon se babait të tij O. S. nga Organi i reformës agrare i janë dorëzuar 00.89.80 ha të ngastrës kadastrale 305/2(prona e kërkuar);
 - Regjistër i ekonomisë për vitet 1950-1951 pa datë dhe pa vulë me të cilin dëshmohet se familja S. kujdesen për pasurinë e paluajtshme në sipërfaqe prej 5.28.93 ha të pa specifikuar numri i ngastrës.
 - Autorizim i pa certifikuar me të cilin M. S. e ëma e paraqitësit të kërkesës e autorizon V. Š. në vitin 1989;
 - një hartë të vizatuar me dorë ku ndodhej prona e kërkuar;
 - letërnjoftim lëshuar me 3 Mars 2004 në Podgoricë.
3. Më 20 Mars 2007 Ekipi i AKP-së ka bërë identifikimin e pronës së kërkuar duke vendosur afishe në pronën e kërkuar. Nga njoftimi është gjetur se prona e kërkuar është tokë bujqësore, mal dhe kullose pa ndërtesa. Më 1 Korrik 2010 Ekipi i KPA-së konfirmoi se notifikimi ishte i saktë dhe se shenja ishte vendosur në hyrje të fshatit Kadrali. Njoftimi ishte publikuar në Gazetën e AKP-së Nr.3 dhe në buletin e zyrës për Prona të UNHCR-së në Beograd.
4. Askush nuk ishte përgjigjur në kërkesë.

5. Bazuar në raportin e verifikimit 3 tetor 2013 dokumentet e parashtruara nga paraqitësi i kërkesës ishin verifikuar negativisht. Sipas detyrës zyrtare AKP-ja kishte siguruar Certifikatën e Pronësisë të datës 8 Mars 2012 që dëshmon se ish ngastra kadastrale 305/2 tani ishte e evidentuar si ngastër me numër 33/1 dhe ishte e regjistruar në emër të palës së tretë
6. Më 27 Nëntor 2013 KKKPK-ja përmes vendimit të vet KPCC/D/A/220/2013, e ka refuzuar kërkesën me arsyetimin (paragrafin 145 dhe 146) se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmoi ndonjë të drejtë pronësore në pronën e kërkuar dhe se Sekretaria ekzekutive e AKP-së nuk ka mundur të siguroi sipas detyrës zyrtare asnjë dëshmi në favor të pretendimeve të paraqitësit të kërkesës. Certifikata e regjistrimit të përkohshëm e vitit 1939 nuk u gjend në regjistrat publik dhe sipas të dhënave në kadastrit përkatës ngastra e kërkuar kishte pësuar ndryshime dhe tani ishte e evidentuar në emër të palës së tretë
7. Vendimi i KKKPK-së është pranuar nga paraqitësi i kërkesës më 20 Qershor 2014 dhe me 30 qershor 2014 K.Š., (më tej paraqitësi i ankesës) ka paraqitur ankesë në vendimin e Komisionit duke i bashkangjitur ankesës vetë letërnjoftimin e lëshuar me 16 Mars 2009 në Budva të malit të Zi
8. Me 20 Maj 2016 Gjykata Supreme lëshoi një urdhër me të cilin i urdhëroi palës ankuese që të sjellë dëshmi se ai mund të paraqesë ankesë në emër të V. S. dhe të përgjigjet në pyetjet se cila është lidhja familjare me paraqitësin e kërkesës; ose të sjellë një autorizim nga paraqitësi i kërkesës. Pala ankuese u urdhërua që të dëshmoi se a ka autorizim apo lidhje familjare me paraqitësin e kërkesës.
9. Pala Ankuese nuk ka sjellë asnjë përgjigje lidhur me Urdhrin e Gjykatës

Pretendimet e palëve

10. Pala Ankuese pretendon se prona ka qenë e regjistruar në regjistrat e tokës në vitin 1939 dhe se konstatimi se e njëjta është e regjistruar tani në emër të palës së tretë është i pasaktë. Kërkon nga Gjykata që ta informoi se si ka mundur pala e tretë të regjistroi pronën në emër të saj pa dokumente valide.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

11. Gjykata vëren se ankesa është e paraqitur nga pala ankuuese pa një autorizim valid pa një dëshmi për lidhjen familjare të palës ankuuese me paraqitësin e kërkesës. Për këtë arsye ankesa është e palejueshme.
12. Gjykata gjeti se ankesa është e palejueshme referuar nenit 186.3 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008) (më tej LPK) ku parashihet se *“Ankesa është e palejueshme po që se e ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj,”*
13. Po ashtu referuar dispozitave të nenit 5 të Urdhëresës administrative nr. 2007/05 për zbatimin e Rregullores UNMIK/REG/2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e patundshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale paraqitësi i kërkesës nuk i përmbush kriteret. Kjo nga se paraqitësi i kërkesës nuk e ka cilësinë e palës as që ka autorizim për ta përfaqësuar titullarin. Ajo nuk ka dëshmuar se është anëtarë i ngushtë i familjes së paraqitësit të kërkesës sipas dispozitës së nenit 1 paragr.12 të Urdhëresës, që ka të bëjë me përkufizimin si *“Anëtar i familjes”* nënkupton *bashkëshorti apo bashkëshortja, fëmijët (e lindur në martesë apo të birësuar) dhe personat e tjerë, të cilët është i obliguar t'i përkrabë poseduesi i të drejtës në pronë në përputhje me ligjin në fuqi, apo personat që janë të obliguar ta përkrabin poseduesin e të drejtës në pronë në përputhje me ligjin në fuqi,”*
15. Si rrjedhojë, gjykata nuk gjen asnjë arsye se pse pala ankuuese duhet të ketë të drejtë të paraqes ankesë, si palë për interesat e veta dhe as si përfaqësues i paraqitësit të kërkesës për mungesë të autorizimit valid.
16. Gjykata duke e konsideruar ankesën si të palejueshme nuk shqyrtoi meritat e por gjeti se Vendimi i Komisionit është nxjerrë në përputhje me ligjin procedural dhe material.
17. Në bazë të mësipërmes dhe në pajtim me nenin 13.3 nën b, të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, gjykata vendosi si në dispozitiv.

Këshillë juridike

18. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit

Beshir Islami, Gjyqtar

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it